

KOMUNIKATË PËR MEDIA


Statistikat e Arsimit në Kosovë, 2024/2025

05.06.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) publikon Statistikat e Arsimit për vitin shkollor 2024/2025.

Më pak nxënës dhe studentë sesa një vit më parë

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve në sektorin publik dhe privat



Rritje e lehtë e numrit të fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor

Numri i fëmijëve në çerdhe dhe parashkollor për vitin shkollor 2024/2025 ishte 34 038, ku krahasuar me vitin paraprak (2023/2024), që ishte 32 818 fëmijë, kishte një rritje të lehtë të numrit prej 1 220 fëmijë më shumë.

Në sektorin publik në vitin shkollor 2024/2025 ishin 23 349 fëmijë ose 68,6%, ndërsa në sektorin privat 10 689 fëmijë ose 31,4%. Krahasuar me vitin paraprak (2023/2024) në sektorin publik ishin 24 104 fëmijë ose 73,4% ndërsa në sektorin privat 8 714 fëmijë ose 26,6%.

Interesim më i madh në sektorin privat në vitin shkollor 2024/2025, krahasuar me 2023/2024

Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin shkollor 2024/2025 ishte 208 515, prej tyre në sektorin publik ishin 199 190 ose 95,5% dhe në sektorin privat 9 325 ose 4,5%. Krahasuar me vitin shkollor 2023/2024, ku numri i nxënësve ishte 215 431, prej tyre në sektorin

publik ishin 206 941 ose 96,1% dhe në sektorin privat 8 490 ose 3,9%. Nga kjo mund të shohim se sektori publik ka një rënie të numrit të përgjithshëm, kurse sektori privat ka një rritje të lehtë të numrit të nxënësve krahasuar me vitin 2023/2024.

Më pak nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në vitin 2024/2025 ishte 63 551, prej tyre në sektorin publik ishin 58 337 ose 91,8%, ndërsa në sektorin privat ishin 5 214 ose 8,2%. Krahasuar me vitin paraprak 2023/2024 (që ishin 65 757 nxënës, në sektorin publik 60 837 ose 92,5% dhe në sektorin privat 4 920 nxënës ose 7,5%) ka rënie të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Rënie më e madhe vërehet te sektori privat, krahasuar me sektorin publik.

Rënie e lehtë e numrit të studentëve krahasuar me një vit më parë

Numri i përgjithshëm i studentëve në arsimin e lartë në vitin 2024/2025 ishte 64 817, prej tyre në universitetet publike 36 609 studentë ose 56,5%, ndërsa në kolegjet private ishte 28 208 studentë ose 43,5%. Krahasuar me vitin paraprak 2023/2024 (që ishin 70 357 studentë, prej tyre në universitetet publike 39 033 studentë, ose shprehur në përqindje 55,5%, ndërsa në kolegjet private ishte 31 324 studentë ose 44,5%, ka rënie të lehtë të numrit të përgjithshëm të studentëve.

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve në sektorin publik dhe privat, 2023/2024

Niveli	Arsimi	Publik 2023/2024			Privat 2023/2024			Gjithsej 2023/2024		
		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0	Arsimi parashkollor (mosha 0-<6)	12 459	11 645	24 104	4 562	4 152	8 714	17 021	15 797	32 818
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët (klasa 1 – 9)	106 353	100 588	206 941	4 637	3 853	8 490	110 990	104 441	215 431
3	I mesëm i lartë (klasa 10 – 13)	30 430	30 407	60 837	2 441	2 479	4 920	32 871	32 886	65 757
6 - 8	Universitar (6-8)	13 078	25 955	39 033	13 833	17 491	31 324	26 911	43 446	70 357
	Gjithsej	162 320	168 595	330 915	25 473	27 975	53 448	187 793	196 570	384 363

Numri i përgjithshëm i nxënësve dhe studentëve në sektorin publik dhe privat, 2024/2025

Niveli	Arsimi	Publik 2024/2025			Privat 2024/2025			Gjithsej 2024/2025		
		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0	Arsimi parashkollor (mosha 0-<6)	12 097	11 252	23 349	5 548	5 141	10 689	17 645	16 393	34 038
1+2	Fillor dhe i mesëm i ulët (klasa 1 – 9)	102 414	96 776	199 190	5 080	4 245	9 325	107 494	101 021	208 515
3	I mesëm i lartë (klasa 10 – 13)	29 033	29 304	58 337	2 593	2 621	5 214	31 626	31 925	63 551
6 - 8	Universitar (6-8)	11 898	24 711	36 609	12 376	15 832	28 208	24 274	40 543	64 817
	Gjithsej	155 442	162 043	317 485	25 597	27 839	53 436	181 039	189 882	370 921

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Statistikave të Arsimit për vitin shkollor 2024/2025, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Education>